



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 109 dhe 110 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 20 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 21 mars 2014, miraton:

RREGULLORE

**PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E NOMINIMIT DHE PROPOZIMIT PËR
EMËRIM TË KRYEPROKURORIT TË SHTESTIT**

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të cilat do t'i mundësojnë KPK-së, të përcaktojë një proces të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës lidhur me procedurën e nominimit dhe propozimit të kandidatit për emërim për Kryeprokuror të shtetit.

Neni 2
Përkufizimet

2. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, akronimet dhe shprehjet në vijim kanë këto kuptime:
 1. **Ditë**..... nënkupton ditë kalendarike;
 2. **"AKI"**..... nënkupton Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë
 3. **"AKK"**..... nënkupton Agjencinë kundër Korrupsionit;

4. **Komisioni për ri-konsiderim.** nënkupton Komisionin për shqyrtim të kërkesave të paraqitura ndaj vendimeve të panelit të KPK-së për shqyrtim preleminal të aplikacioneve për Kryeprokuror të shtetit;
5. **"KPK"** nënkupton Këshilli Prokurorial i Kosovës
6. **"KPSH"** nënkupton Kryeprokurorin e Shtetit
7. **"NJIF"** nënkupton Njësinë e Inteligjencës Financiare
8. **"NJSHPP"** nënkupton Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve;
9. **"PA"** nënkupton Prokurorinë e Apelit;
10. **Paneli për shqyrtimin preliminar.....** nënkupton panelin për shqyrtim të aplikacioneve për Kryeprokuror të Shtetit
11. **Përvoja ligjore.....** nënkupton përvojën si prokuror, gjykatës, avokat mbrojtës, profesor i të drejtës penale, bashkëpunëtor profesional apo zyrtar ligjor në gjykatë, prokurori, institucion qeveritar apo shtetëror, noter apo këshilltar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve në çështjet penale.
12. **"PSRK"** nënkupton Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
13. **"PSH"** nënkupton Prokurorin e Shtetit
14. **"ZPD"** nënkupton Zyrën e Prokurorit Disiplinor

Neni 3

Kriteret e përgjithshme për nominimin dhe propozimin për Kryeprokuror të Shtetit

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë diplomë të fakultetit juridik, të pranuar sipas ligjeve të Kosovës;
3. Të ketë kaluar provimin e jurisprudencës, të pranuar sipas ligjeve të Kosovës;
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepër penale, me përjashtim të veprave kundërvajtëse;

5. Të këtë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral.

Neni 4 **Kriteret e veçanta për Kryeprokuror të Shtetit**

1. Kandidati për Kryeprokuror të Shtetit duhet të plotësojë këto kriteret të veçanta:
 - 1.1. Të këtë së paku tetë (8) vite përvojë juridike në të drejtën penale;
 - 1.2. Të këtë së paku gjashtë (6) vite përvojë si prokuror i shtetit¹; dhe
 - 1.3. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm.

Neni 5 **Kriteret dhe indikatorët për procesin e nominimit dhe propozimit për emërim për Kryeprokuror të Shtetit**

1. Gjatë procesit të nominimit dhe propozimit të kandidatit për Kryeprokuror të shtetit përveç kriterëve sipas neneve 3 dhe 4, vlerësimi do të bazohet edhe në indikatorët e përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 8, dhe nenet 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6 **Vendimi i KPK-së për shpalljen publike për Kryeprokuror të Shtetit**

1. KPK-ja merr vendim për shpalljen publike të konkursit të brendshëm për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit së paku 4 muaj para skadimit të mandatit të Kryeprokurorit të Shtetit në detyrë.
2. Vendimi për shpalljen publike të konkursit përmbanë afatin e aplikimit, kriteret dhe procedurat për nominimin dhe propozimin për emërim për Kryeprokuror të Shtetit, duke u bazuar në dispozitat Kushtetuese, Ligjin për KPK-në, Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe në këtë Rregullore.
3. Shpallja publike publikohet në ueb faqen e KPK-së, Prokurorit të Shtetit dhe së paku në dy gazeta të përditshme në Kosovë, në dy gjuhët zyrtare;
4. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetata e përditshme;
5. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit sipas formularit 1, dhe vet-vlerësimit sipas formularit 2, është deri në ditën e fundit të mbylljes së konkursit për Kryeprokuror të Shtetit.

¹ Përvoja si prokuror i shtetit konsiderohet përvoja si prokuror publik para hyrjes në fuqi të Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

6. Kandidatët të cilët njoftohen se kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 3, dhe nenit 4 të kësaj rregulloreje, do të ftohen për të dorëzuar koncept dokumentin sipas formularit 3.
7. Afati për dorëzimin e koncept dokumentit është 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së listës përfundimtare të kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret për KPSH.

Neni 7

Dokumentet plotësuese

1. Dokumentet e mëposhtme për secilin kandidat, do të sigurohen nga NJSHPP, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryetarit të KPK-së:
 - 1.1. Vlerësimin e performancës nga ana e eprorit të kandidatit, për tri vitet e fundit;
 - 1.2. Informatat e pranuar nga AKK,
 - 1.3. Informatat e pranuar nga NJIF;
 - 1.4. Informatat e pranuar nga AKI;
 - 1.5. Të dhënat lidhur me masat eventuale disiplinore ndaj kandidatëve dhe informacionet nga ZPD nëse ndaj ndonjë kandidati janë duke u zhvilluar hetime disiplinore nga ZPD.
2. Në rastin kur NJSHPP-ja nuk posedon vlerësimin e performancës së kandidatit nga ana e eprorit të tij, mbetet obligim i kandidatit që ta sigurojë atë vlerësim.

Neni 8

Aplikimi - Forma Standarde e Aplikimit

1. Çdo kandidat për KPSH, duhet të plotësojë formën standarde të aplikimit², e cila do të publikohet në ueb faqen e KPK-së dhe PSH-së, në ditën e shpalljes publike të konkursit.
2. Forma standarde e aplikimit është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Çdo kandidat për KPSH, duhet të plotësojë formën e vet-vlerësimit³ e cila do të publikohet në ueb faqen e KPK-së dhe PSH-së, në ditën e shpalljes publike të konkursit.

² Forma standarde e aplikimit, është pjesë e kësaj rregulloreje.

³ Forma e vet-vlerësimit, është pjesë e kësaj rregulloreje.

4. Forma e vet-vlerësimit është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe është pjesë e poentimit nga anëtarët e Këshillit.

Neni 9

Paneli i KPK-së për Shqyrtimin Preliminar

1. KPK-ja do të themelojë Panelin për Shqyrtimin Preliminar të aplikacioneve për Kryeprokuror të shtetit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Një anëtar i KPK-së; kryetar;
 - 1.2. Një prokuror nga Prokuroria e Apelit, i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe
 - 1.3. Një prokuror nga PSRK-ja, i cili nuk ka aplikuar për KPSH.
2. Paneli ka kompetencë dhe përgjegjësi vetëm për shqyrtimin e aplikacioneve për KPSH, nëse të njëjtat plotësojnë kriteret e parapara me nenin 3 paragrafi 1,2, 3 dhe 4 dhe neni 4 të kësaj rregulloreje.
3. Paneli brenda 7 ditëve shqyrton aplikacionet dhe përpilon listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret për KPSH.
4. Kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim. Njoftimi duhet të përfshijë edhe informatën për të drejtën e kandidatit për të parashtruar kërkesë për ri-konsiderim tek Komisioni për ri-konsiderim në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimin të njoftimit.
5. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim.
6. Njoftimi lidhur me paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni do të publikohet në dy gjuhët zyrtare në ueb faqen e PSH-së dhe KPK-së. Kandidatët do të njoftohen përmes email-it zyrtar dhe mesazhit telefonik. Konfirmimi për pranimin e njoftimit është i obligueshëm nga të gjithë kandidatët për KPSH.

Neni 10

Komisioni për ri-konsiderim

1. KPK-ja themelon Komisionin për ri-konsiderim, me kompetencë dhe përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesave për ri-konsiderim ndaj vendimeve të panelit të KPK-së për shqyrtim preliminar të aplikacioneve të kandidatëve për KPSH.
2. Komisioni për ri-konsiderim është në këtë përbërje:
 - 2.1 Kryeprokurori i Shtetit, kryetar;

- 2.2 Një prokuror nga PA i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe
 - 2.3 Një prokuror nga PSRK i cili nuk ka aplikuar për KPSH.
- 3. Komisioni brenda 5 ditëve nga dita e skadimit të afatit për pranim të kërkesave për ri-konsiderim do të marrë vendim për çdo kërkesë të pranuar.
 - 4. Lidhur me vendimin e Komisionit, do të informohen kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesë për ri-konsiderim, si dhe anëtarët e KPK-së.
 - 5. Vendimet e Komisionit publikohen në ueb faqe të KPK-së dhe PSH-së, më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

Neni 11

Natyra publike e takimeve të Panelit dhe Komisionit

- 1. Puna e Panelit dhe Komisionit nga nenet 9 dhe 10 janë publike për shoqërinë civile dhe OJQ-të e specializuara në fushën e sundimit të ligjit.
- 2. KPK-ja publikon njoftimin për oraret e takimeve të panelit dhe komisionit përmes ueb faqes së KPK-së dhe PSH-së, së paku 48 orë para mbajtjes së takimeve.
- 3. Njoftimi përfshinë: datën e takimit, kohën dhe vendin.
- 4. KPK-ja përmes sekretariatit do të mbajë procesverbal lidhur me vendimet e çdo takimi.

Neni 12

Komisioni për vlerësim, intervistim dhe votim

- 1. Anëtarët e KPK-së, të cilët nuk përjashtohen sipas paragrafit 5 të nenit 20 të ligjit për KPK-në, e përbejnë komisionin për vlerësim, intervistim dhe votim për KPSH.

Neni 13

Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit

- 1. Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit do të përfshijë: Integritetin personal, profesional dhe moral, i cili bazohet në:
 - 1.1. Vlerësimin e performances për tri vitet e fundit;
 - 1.2. Informatat e pranuar nga AKK;

- 1.3. Informatat e pranuara nga NJIF;
 - 1.4. Informatat e pranuara nga AKI;
 - 1.5. Të dhënat lidhur me masat eventuale disiplinore ndaj kandidatëve dhe informacionet nga ZPD-ja nëse ndaj ndonjë kandidati janë duke u zhvilluar hetime disiplinore.
2. Obligohet Kryeprokurori i shtetit që të kërkoj informatat nga paragrafi 1, pikat 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për KPSH. Këto informata vendosen në dosjen e kandidatit dhe në to kanë qasje anëtarët e KPK-së.
 3. Informatat nga paragrafi 1, pika 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5, të këtij neni, për kandidatët të cilët eliminohen nga Paneli dhe Komisioni për ri-konsiderim i dorëzohen Kryeprokurorit të ardhshëm.

Neni 14

Intervistimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit

1. Intervistimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit bazohet në formën e vetë-vlerësimit⁴ dhe koncept dokumentit⁵:
2. Vetë-vlerësimi, do të përmbajë:
 - 2.1 Udhëheqja dhe lidhshëria;
 - 2.2 Shkathtësitë menaxheriale dhe aftësitë për arritjen e rezultateve;
 - 2.3 Puna me njerëz dhe menaxhimi i tyre;
 - 2.4 Shembull për të tjerët dhe integritet; dhe
 - 2.5 Njohuri dhe përvojë praktike nga sistemi i drejtësisë penale (duke përfshirë çështjet relevante të të drejtave të njeriut).
3. Koncept dokumenti i kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit duhet të përmbajë:
 - 3.1. Vizioni lidhur me politikën dhe strategjitë për Prokurorin e Shtetit dhe KPK-në për shtatë vitet e ardhshme;
 - 3.2. Aftësia drejtuese dhe lidhshëria për të udhëhequr sistemin prokurorial në shtatë vitet e ardhshme;
 - 3.3. Shkathtësitë dhe aftësitë menaxheriale për shtatë vitet e ardhshme;

⁴ Forma me numër 2

⁵ Forma me numër 3 përfshinë vlerësimin e koncept dokumentit dhe intervistës me gojë.

- 3.4. Vizioni për të menaxhuar me personelin në sistemin prokurorial; dhe
- 3.5. Integriteti, njohuri dhe përvojë praktike të sistemit të së drejtës penale, duke përfshirë çështjet relevante të të drejtave të njëriut.
4. Koncepti dokumenti nuk duhet të përmbajë më pak se 20 faqe dhe jo më shumë se 30 faqe, me shkrim të llojit 'book antiqua', madhësia e shkronjave 12, hapësirë njëshe.
5. Pjesë e intervistimit është edhe intervista me gojë, që përfshinë:
 - 5.1. Intervistimin e secilit kandidat, i cili ka dorëzuar formën e aplikacionit dhe konceptin dokumentin për mandatin shtatë vjeçar;
 - 5.2. Secila intervistë do të zgjatë 60 deri 120 minuta, duke përfshirë prezantimin e vizionit të paraqitur në konceptin dokument;
 - 5.3. Qasjen e njëjtë për të gjithë kandidatët, lidhur me natyrën e pyetjeve dhe kohëzgjatjen e intervistës.
 - 5.4. Pyetjet që mund të përdoren gjatë intervistës do të dizajnohen për të marrë informata relevante lidhur me faktorët specifik të përzgjedhjes duke përfshirë pyetjet e standardizuara. Gjatë intervistës mund të parashatrohen pyetje shtesë bazuar në përgjigjet e dhëna nga kandidati.
 - 5.5. Si pjesë e intervistës, secili kandidat do të bëjë prezantim me gojë (20-30 minuta) duke prezantuar synimet kryesore të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së për mandatin shtatë vjeçar, sfidat kryesore të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së si dhe propozimet për realizimin e synimeve dhe adresimin ndaj sfidave. Pyetjet mund të parashatrohen bazuar në prezantimin me gojë.

Neni 15

Ofrimi i informatave për konceptin dokumentin

1. KPK-ja do të vë në dispozicion dokumentet në vijim për secilin kandidat për Kryeprokuror të Shtetit që të ndihmojë atë në përgatitjen e konceptit dokumenti:
 - 1.1 Raportet vjetore të KPK-së dhe të Prokurorit të Shtetit për tri vitet fundit;
 - 1.2 Organogramin e stafit të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së;
 - 1.3 Raportin vjetor të vitit paraprak të Mekanizmit përcjellës për harmonizimin e raporteve statistikore;
 - 1.4 Buxhetin vjetor të Prokurorit të Shtetit;

- 1.5 Raportin mbi anketën e Prokurorëve për vitin 2013, të miratuar në KPK.
 - 1.6 Raportin e Komisionit për mbikëqyrjen dhe verifikimin e të dhënave statistikore për veprat penale të korrupsionit;
 - 1.7 Raportin e trajnimeve të ndjekura nga Prokurorët dhe stafi mbështetës;
 - 1.8 Planin vjetor të punës së KPK-së për vitin vijues.
2. Dokumentet e përmendura më lart mund të merren në NJSHPP-së nga të gjithë kandidatet për Kryeprokurore të Shtetit.

Neni 16 Poentimi i kandidatëve

1. Poentimi i kandidatëve bëhet në formulët me numër 2 dhe 3.
2. Çdo anëtar i KPK-së i poenton kandidatët sipas formularëve 2 dhe 3;
3. Poenat e të gjithë anëtarëve të KPK-së mblidhen në një formular të vetëm për çdo kandidat.
4. Pas poentimit të kandidatëve, KPK-ja bën renditjen e kandidatëve sipas poenave të fituara gjatë procesit të vlerësimit dhe intervistimit, duke renditur tre kandidatët më së shumti poena.
5. Çdo anëtar i KPK-së, mund t'a poentojë një kandidat me më së shumti 100 (njëqind) poena, si në vazhdim:
 - 5.1 Për dokumentin e vetë-vlerësimit një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;
 - 5.2 Për koncept dokumentin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena;
 - 5.3 Për intervistën me gojë një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;
 - 5.4 Për integritetin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena.
6. Tre (3) kandidatët me më së shumti poena, do t'i nënshtrohen procesit të votimit të fshehtë nga anëtarët e KPK-së.

7. Kandidati i cili nuk hynë në listën e tre (3) kandidatëve për votim në KPK, brenda tre (3) ditëve pas njoftimit, mund të kërkoj nga KPK-ja të ri-konsiderojë kërkesën e tij vetëm mbi bazën nëse konsideron se ka pasur shkelje procedurale në zbatimin e kësaj rregulloreje.
8. Njoftimi nga paragrafi 7, i këtij neni bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet një kopje e poentimit të përgjithshëm të kandidatit.
9. Kandidatët të cilët nuk janë renditur ndër tre (3) të parët me më së shumti poena, kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentin e vlerësimit të tij për të verifikuar poentimin. Mirëpo, kandidati nuk ka të drejtë qasje në identitetin e anëtarit të KPK-së i cili ka bërë vlerësimin dhe poentimin individual.
10. KPK-ja në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të kërkesës së kandidatit për të verifikuar poentimin, do të vendosë nëse kërkesa pranohet apo refuzohet dhe njofton me shkrim kandidatin për marrjen e vendimit.

Neni 17

Procesi i votimit për kryeprokuror të shtetit

1. Tre (3) kandidatët e parë, të cilët marrin më së shumti poena, do të hyjnë në procesin e votimit të fshehtë.
2. Votimi i tre (3) kandidatëve të parë të renditur sipas poenave bëhet me vota të fshehta nga anëtarët e KPK-së, duke përjashtuar anëtarin e KPK-së nëse ai është njëri prej tre kandidatëve për të cilin do të votohet.
3. Nëse votimi i fshehtë rezulton me barazim, votimi i fshehtë do të përsëritet vetëm për kandidatët që kanë marrë vota të barabarta, deri në votimin në të cilin një kandidat merr votat e nevojshme për KPSH.
4. Kandidati i cili në votimin e fshehtë fiton më së shumti vota nga anëtarët e KPK-së do të propozohet për emërim për kryeprokuror të shtetit tek Presidenti i Republikës së Kosovës.
5. Propozimi për emërim nënshkruhet nga Kryetari i KPK-së. Propozimi për emërim duhet të jetë i arsyetuar me shkrim, duke përfshirë gjithë procesin e nominimit të kandidatit të propozuar për emërim për Kryeprokuror të shtetit.
6. Propozimi për emërim të kandidatit për KPSH nga KPK-ja, i dërgohet Presidentit të shtetit, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e marrjes së vendimit.
7. Mbledhja dhe votimi i fshehtë i KPK-së, mbahet i hapur për publikun, por KPK-ja mund të votojë për të mbyllur pjesën e mbledhjes gjatë së cilës diskutohen meritat e kandidatëve për KPSH.

Neni 19
Publikimi i koncept dokumentit

1. Pas emërimit të Kryeprokurorit të shtetit nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, KPK-ja publikon koncept dokumentin e tij në ueb faqe të KPK-së dhe të PSH-së.

Neni 20
Gjuhët

1. Procesi i përzgjedhjes së KPSH-së zhvillohet në gjuhët zyrtare të Kosovës.
2. Aplikimi bëhet në gjuhët zyrtare të Kosovës.
3. Dokumentet dërgohen në gjuhët zyrtare të Kosovës. Aty ku dokumentet mbështetëse janë të shkruar në gjuhë të ndryshme, ato duhet të shoqërohen me përkthim gjuhët zyrtare të Kosovës.
4. Intervistat zhvillohen në gjuhët zyrtare të Kosovës.
5. Aplikuesit në formën e aplikacionit duhet të specifikojnë se në cilën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës preferojnë të intervistohen.

Neni 21
Konflikti i interesit

1. Legjislacioni lidhur me konfliktin e interesit, sipas nenit 16 të Rregullores mbi Punën dhe Veprimtarinë e KPK-së dhe Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë dhe anëtarë të KPK-së do të zbatohen lidhur me aktivitetet e mbuluara nga kjo Rregullore.

Neni 22
Komunikimi Jozyrtar gjatë Procesit të nominimit dhe propozimit për emërim të Kryeprokurorit të shtetit

1. Nga afati i fundit për dërgimin e formave të aplikacionit dhe të vet-vlerësimit deri në datën e propozimit për emërim të kandidatit për KPSH tek Presidenti, asnjë anëtar i Panelit të KPK-së, Komisionit për ri-konsiderim dhe stafit të KPK-së apo Prokurorit të Shtetit nuk do të ketë komunikim jozyrtar me kandidatin për KPSH. Shkelja e kësaj dispozite rezulton me procedurë disiplinore.
2. Nga afati i fundit për dërgimin e formave të aplikacionit dhe të vet-vlerësimit deri në datën e emërimit tek Presidenti, asnjë person aplikacioni për pozitën e

Kryeprokurorit të Shtetit i të cilit është në konsiderim nuk do të angazhohet në komunikim jozyrtar lidhur me aplikacionin e tyre me ndonjë anëtar të Panelit, Komisionit dhe anëtarëve të KPK-së. Shkelja e kësaj dispozite do të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të integritetit të kandidatit.

Neni 23

Mbrojtja e të Dhënave dhe Fshtësia

1. Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale zbatohet lidhur me aktivitetet e mbuluara nga kjo Rregullore.

Neni 24

Afatet kohore dhe dispozitat e Fundit

1. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit i paraqitur në këtë Rregullore do të zhvillohet në pajtim me afatin kohor në vijim:

Neni	Procesi i përzgjedhjes / procedurat	Afatet kohore
6	Vendimi i KPK-së për të shpallur konkursin për aplikim për KPSH	1
6	Mbyllja e afatit të aplikimit për KPSH	15
7	Parashtrimi i kërkesave tek institucionet në pajtim me nenin 7	15
9	Themelimi i panelit për shqyrtim preliminar (Takimi i KPK-së)	16
10	Themelimi Komisionit për Ri-konsiderim (Takimi i KPK-së)	16
9	Shqyrtimi i aplikacioneve nga ana e Panelit për shqyrtim preliminar dhe njoftimi i kandidatëve për të drejtën e parashtrimit të kërkesës për ri-konsiderim tek komisioni për Ri-konsiderim	23
10	Afati i fundit për pranimin e kërkesave për Ri-konsiderim.	28
10	Komisioni për ri-konsiderim merr vendim lidhur me kërkesat e kandidatëve për ri-konsiderim dhe njofton kandidatët.	32
9	Shpallja e listës së kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret për KPSH	32
6	Njoftimi i kandidatëve për afatin e dorëzimit të koncept dokumentit, dhe vënia në dispozicion e dokumenteve për t'i ndihmuar në përgatitjen e koncept dokumentit	32
6	Mbyllja e afatit për dorëzimin e koncept dokumentit	46
5	Komisioni për vlerësim, intervistim dhe votim i analizon formularët me numër 1, 2 dhe 3, dokumentet e parashtruara nga kandidatët për KPSH, si dhe informatat e pranuar nga institucionet sipas nenit 7.	55
13	Fillimi i Intervistimit të kandidatëve për KPSH	56
13	Përfundimi i intervistave të kandidatëve për KPSH	70
16	Njoftimi me shkrim i kandidatëve dhe shpallja publike e listës së kandidatëve të renditur sipas poenave.	72
16	Afati i fundit i kandidatëve për të parashtruar kërkesë për rikonsidim dhe për verifikim të poenave.	74
16	Afati i fundit për njoftimin e kandidatit lidhur me vendimin e KPK-së për pranimin e apo refuzimin e verifikimit të poenave.	80
17	Procesi i votimit për kryeprokuror të Shtetit.	81-82

17	Afati i fundit për dërgimin e propozimit për emërim të KSHP-së, tek Presidenti i shtetit.	87
17	Pranimi i dekretit të emërimit të KPS nga ana e Presidentit të shtetit.	96
19	Publikimi në ueb faqe i koncept dokumentit të kryeprokurorit të shtetit të emëruar nga Presidenti i shtetit.	99

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë: 21/03/2014

Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Ismet Kabashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Forma numër 1

FORMULARI PËR APLIKIM PËR POZITËN KRYPROKUROTIT TË SHTETIT

Procedure e Aplikimit	
Nr. i regjistrimit	Data

1. Të dhënat personale

Mbi emri		Emri		[] Mashkull [] Femër
----------	--	------	--	------------------------

Adresa e tanishme:

2. Informata lidhur me disa të afërt

3.1 A është ndonjë nga të afërmit tuaj pjesëtar i KPK-ës? PO ☐ JO ☐

3.2 A është ndonjë nga të afërmit tuaj i punësuar në KPK apo në Prokurorinë e Shtetit? PO ☐ JO ☐

Nëse përgjigja ndaj ndonjërës nga pyetjet më lartë është "Po", atëherë jepni të dhënat si në vijim:

Emri	Marrëdhënia	Institucioni dhe pozita

3. A keni jetuar jashtë Kosovës gjatë 20 viteve të fundit? PO ☐ JO ☐

Shënoni të gjitha vendet jashtë Kosovë në të cilat keni jetuar gjatë 20 viteve të fundit, duke filluar nga vendbanimi i tanishëm (duke përjashtuar qëndrimet për arsye të udhëtimit dhe festave)

Qyteti / Fshati:	
Adresa / Rruga :	

prej (muaji/viti):			
deri (muaji/viti):			
Qyteti / Fshati:			
Adresa / Rruga:			
prej (muaji/viti):			
deri (muaji/viti):			
4. Anëtarësia në parti politike			
Deklaroj se nuk jam pjesëtar i ndonjë partie politike. PO ☐			
Nënshkrimi: _____		Data: _____	
5. Ankesat ndaj jush			
Kjo pjesë ka tetë pyetje. Përgjigjuni në secilën pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ofroni informacionin e kërkuar.			
5.1A është paraqitur ndonjëherë ankesë ndaj jush në ndonjë organ disiplinor? PO ☐ JO ☐			
Data e ankesës			
Paraqitur në		Emri i ankuesit	
Përshkruaj:			
A keni qenë të informuar lidhur me paraqitjen e ankesës? PO ☐ JO ☐			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
5.2 A është zhvilluar ndonjëherë procedure hetimore ndaj jush si rezultat i ndonjë ankesë? YES ☐ NO ☐			
Data e nisjes së hetimit			
Hetime u zhvilluan nga (institucioni)			
Qyte ti		Shteti	
A keni qenë i njoftuar lidhur me nisjen e hetimeve? PO ☐ JO ☐			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	

5.3 Si rezultat i këtij hetimi, a është rekomanduar ndonjë masë sanksionuese (p.sh. vërejtje, gjobe, punë provuese, pushim i detyrueshëm, rehabilitim, shkarkim, ulje në pozitë apo ndonjë masë tjetër sanksionuese)? PO ☐ JO ☐			
Data e rekomandimit			
Autoritetit rekomandues			
Përmbajtja e rekomandimit			
Qyteti		Shteti	
A keni qenë të informuar lidhur me rekomandimin PO ☐ JO ☐			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
5.4 Përshkruani hapat e ndërmarrë nga ana e organit përkatës në lidhje me rekomandimin:			
5.5 A ju është shqiptuar ndonjëherë masa e sanksionimit si p.sh vërejtje, gjobë, punë provuese, pushim i detyrueshëm, rehabilitim, shkarkim ose ulje në pozitë apo ndonjë lloj tjetër i sanksionimit si rezultat i rekomandimit ? PO ☐ JO ☐			
Masa sanksionuese			
Shqiptuar nga		Data e sanksionimit	
A keni qenë të informuar lidhur me masën sanksionuese? PO ☐ JO ☐			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
5.6 A është zbatuar masa disiplinore ? PO ☐ JO ☐			
Data e fillimit të zbatimit të masës sanksionuese:			
Data e përfundimit të zbatimit të masës disiplinore:			
5.7 A ju është shqiptuar ndonjëherë masa për suspendim të përkohshëm? PO ☐ JO ☐			
Kërkesa për suspendim ishte bërë nga			
Autoriteti i ngarkuar me imponimin e masës së suspendimit		Data e vendimit	

Kohëzgjatja e suspendimit	
5.8 Jepni informata shtesë që ndërlidhën me pjesën nr. 5 të këtij formulari, për të cilat ju mendoni se janë të rëndësishme për tu adresuar gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit tuaj	

6.Shkeljet penal dhe civile			
Kjo pjesë ka njëmbëdhjetë pyetje. Përgjigjuni në çdo pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ju lutemi jepni informatat e kërkuara.			
6.1.A jeni hetuar ndonjëherë për ndonjë vepër të pandehur penale?			
PO ☐ JO ☐			
Data kur kanë nisur hetimet		Data kur kanë përfunduar hetimet	
Hetimet u zhvilluan nga (institucioni)			
Qyteti ku ishin zhvilluar hetimet		Shteti	
Lloji i veprës penale:			
6.2.A keni qenë ndonjëherë i arrestuar apo i dyshuar për aktivitet kriminal?			
PO ☐ JO ☐			
Data e arrestimit		Qyteti	Shteti
I arrestuar nga (institucioni)			
Arsyeja e arrestimit:			
6.3.A keni qenë i akuzuar ndonjëherë për vepër penale?			
PO ☐ JO ☐			
Data e ushtrimit të aktakuzës			

Vendi i ushtrimit të aktakuzës		Shteti	
I akuzuar për			
Përshkruani rastin shkurtimisht:			
6.4.A jeni gjykuar ndonjëherë për vepër penale? PO ☐ JO ☐			
Data e dënimit		Gjykata	
Qyteti		Shteti	
I dënuar për			
Natyra e vendimit të gjykatës (përshkruani vendimin):			
6.5. Nëse kundër vendimit të shkallës së parë është ushtruar ankesë me mjetë të rregullta juridike, ju lutemi plotësoni informacionin e kërkuar në vijim.			
Data e vendimit të shkallës së dytë		Gjykata e shkallës së dytë	
Qyteti		Shteti	
1.6 Nëse vendimi është kundërshtuar me anë të mjeteve të rregullta juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?			
1.7 Nëse është shqiptuar ndonjë masë sanksionuese nga gjykata, a është zbatuar ajo? PO ☐ JO ☐			

Gjykata që bëri zbatimin		Qyteti		Shteti
1.8 A keni marrë pjesë ndonjëherë në cilësinë e paditësit apo të paditurit në gjykatë civile apo ekonomike (duke përjashtuar rastet e shkurorëzimit)? PO ☐ JO ☐				
Data e procesit gjyqësor		Gjykata		
Gjykata ku është ushtruar procedura gjyqësore			Shteti	
Përshkrimi i procesit gjyqësor:				
1.9 Nëse kundër vendimit është ushtruar ankesë me mjetë të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?				
1.10 A keni vepruar ndonjëherë në cilësinë e debitorit në ndonjë procedurë apo të kreditorit në procedurë të ekzekutimit? PO ☐ JO ☐				
Data kur është ushtruar padia për ekzekutim				
Qyteti		Shteti		
Gjykata				
Përshkrimi i padisë:				

1.11 A keni qenë ndonjëherë objekt i procedurës penale për ndonjë shkelje të vogël penale?			
PO ☐ JO ☐			
Institucioni që kishte nisur procedurën			
Data e nisjes së procedurës		Gjykata	
Qyteti		Shteti	
Përshkruani natyrën e vendimit të gjykatës:			
2. GJUHA PËR INTERVISTË			
Dëshiroj të intervistohem në:			
☐ Gjuhën Shqipe			
☐ Gjuhën Serbe			

Autorizimi për kërkimin dhe dhënien e informatave personale	
Me anë të nënshkrimit tim:	
-	Unë e autorizoj KPK-ën që të marrë informata për mua nga organet e shënuara më poshtë;
-	Unë i autorizoj organet e shënuara më poshtë që t'i ofrojnë KPK-ës informatat e mia personale
-	Këto organe janë:
-	Policia e Kosovës, Gjykatat e Kosovës dhe organet përkatëse në shtetet tjera që mbajnë shënime të hetimeve penale dhe dënimeve;
-	Njësia e Inteligjencës Financiare;
-	Agjencia kundër Korrupsionit.
-	Agjencia Kosovës për Inteligjencë.
Data:	Nënshkrimi:

Deklarimi dhe konfirmimi

Me anë të nënshkrimit tim, unë deklaroj se:

- Informatat në këtë formular aplikimi dhe në formularin për vetëvlerësim si dhe informatat e përfshira në shtojcat e këtij formulari për emërim si prokuror janë të vërteta dhe të sakta, dhe janë bërë nën përgjegjësinë për deklaram të rrejshëm;
- E autorizoj Këshillin Prokurorial të Kosovës për të verifikuar këto informata;
- Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi unë do ta humb të drejtën emërimit si Kryeprokuror i Shtetit;
- Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi apo formularin e vetëvlerësimit, e i cili do të zbulohet pas emërimit tim si Kryeprokuror i Shtetit, menjëherë mund të jem objekt i procedurës disiplinore dhe të rekomandohem për shkarkim nga pozita e Kryeprokurorit të Shtetit.

Data:

Nënshkrimi: _____

Lista e dokumenteve (të fotokopjuara, jo origjinale) për dorëzim

1. Dekreti Presidencial për emërim dhe riemërim;
2. Certifikatat e Trajnimit
3. Certifikata e Shkollimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Forma numër 2

FORMULAR I VETË-VLERËSIMIT
PËR POZITËN E KRYEPROKURORIT TË SHETIT

<u>Të dhëna personale</u>			
<u>Mbiemri</u>		<u>Emri</u>	[] Mashkull [] Femër
Kualifikimet dhe Aftësitë - Vetë-Vlerësim Vetë-vlerësimi përbën një pjesë të rëndësishme të aplikacionit tuaj dhe ju lejon që të paraqitni shembuj se si ju keni demonstruar kualitetet dhe aftësitë nga përvoja e juaj e mëparshme. Ju mund të paraqitni shembuj jashtë punës suaj në Prokurorinë e Shtetit duke përfshirë edhe përvojën tuaj nga jeta personale. Vetë-vlerësimi nuk duhet thjesht të jetë përsëritje e historikut të punës suaj. Ju lutemi të jeni konciz, përgjigjuni çdo treguesi, meqë kufizimi i paraparë për çdo katrorë është prej 250 - 500 fjalë. Formulari për shënime (pika) është i pranueshëm dhe ju lutemi të përdorni vetëm fontin book antiqua 11. Ju lutemi të jepni shembuj specifik të cilët demonstrojnë se si mund të maten shkathtësitë tuaja me kualitetet dhe aftësitë e kërkuara të nivelit të përshtatshëm për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Nuk mjafton të shkruani në mënyrë të përgjithshme lidhur një situatë dhe and çfarë ka ndodhur - ne dëshirojmë ta dimë konkretisht se çfarë keni menduar, cilat veprime i keni ndërmarrë, si e keni trajtuar situatën dhe rezultatin.			

Udhëheqja dhe caktimi i drejtimit

Treguesit (Pyetjet):

- Aftësi për të formësuar objektiva afatgjata për Prokurorin e Shtetit në bashkëpunim dhe konsultim me të tjerët për të krijuar një Prokuror të Shtetit që do të jetë i pavarur, i paanshëm, profesionist, dhe llogaridhënës dhe që reflekton natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimin e barazisë gjinore;
- Aftësi për të identifikuar problemet sistemore ose dobësitë dhe të ndërmerr veprim të përshtatshëm për zgjidhjen e tyre;
- Aftësi për të zhvilluar dhe mbajtur komunikim të efekshëm me institucionet relevante që janë brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë penale të Kosovës;
- Aftësi për të kuptuar marrëdhëniet e jashtme të Prokurorit të Shtetit dhe të drejtojë dhe balancojë me kategorinë e presioneve politike, nacionale dhe ndërkombëtare;
- Aftësi për të siguruar adresimin e objektivave dhe nevojave të Prokurorit të Shtetit;
- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të efektshme dhe pozitivisht me mediet;
- Qartëson dhe formëson rolin e Prokurorit të Shtetit gjatë kryerjes së shërbimeve për publikun.

Shkathtësitë menaxhuese dhe aftësitë për arritjen e rezultateve

Treguesit (Pyetjet):

- Të jetë i aftë që të planifikojë dhe organizojë punën e Prokurorit të Shtetit për të siguruar që Prokurori i Shtetit të arrijë rezultate
- Në mënyrë të efektshme të delegojë dhe zhvillojë strukturat menaxheriale dhe organizative;
- Të jetë në gjendje të kuptojë dhe të përdor një spektër të gjerë të menaxhimit të informacionit (p.sh., buxhetet financiare, statistikën e performancës) në mënyrë kompetente dhe të veprojë në bazë të asaj se çfarë tregojnë ato;
- Të jetë në gjendje të promovojë përdorimin e mjeteve profesionale të menaxhimit dhe të zhvillojë teknika të reja për të pasur përmirësim të rezultateve;
- Të jetë në gjendje të krijojë një kulturë të fleksibilitetit dhe të reagimit, të mobilizojë të tjerët për të reaguar shpejt ndaj ndryshimit të nevojave dhe prioriteteve dhe duke siguruar që rëndësia e arritjes së objektivave të komunikohet dhe të kuptohet nga i gjithë stafi i Prokurorit të Shtetit;
- Të jetë në gjendje të analizojë arsyet e suksesit dhe të dështimit dhe të sigurojë që mësimet e nxjerra nga përvoja të jenë mësuar dhe veprimet të ndërmerren.

Puna me njerëz dhe menaxhimi i tyre

Treguesit (Pyetjet):

- Aftësia për të ndërtuar dhe mirëmbajtur raporte pozitive me të tjerët brenda Prokurorisë së Shtetit dhe për të vlerësuar mendimet dhe punën e të tjerëve brenda Prokurorisë së Shtetit
- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të efektshme brenda Prokurorisë së Shtetit; mund të inicojë dhe të ruaj mbështetjen dhe përkushtimin e të tjerëve për ndryshime, por të jetë në gjendje të paraqes mesazhet jo të popullarizuara në mënyrë të efektshme;
- Aftësi për të promovuar dhe mbështetur fokusin në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës dhe fasiliton të tjerët për të identifikuar dhe zgjidhur problemet;
- Aftësi për të siguruar zhvillimin e shkathtësive profesionale dhe të njohurisë për gjithë stafin e Prokurorisë së Shtetit me qëllim të avancimit të performancës dhe të profesionalizmit;
- Aftësi për të menaxhuar individët dhe zyrat me konsistencë, profesionalizëm, objektivitet dhe në mënyrë të drejtë dhe të krijojë një mjedis të mirë për punë për gjithë stafin e Prokurorisë së Shtetit; njeh dhe shpërblen performancën e mirë dhe shqyrton performancën e dobët.

Shembull për të tjerët dhe me integritet

Treguesit (Pyetjet):

- Demonstron aftësi për të gjykuar mirë në situata personale dhe profesionale në pajtim me standardet më të larta profesionale;
- Personalisht pajtohet me parimet dhe dispozitat nga Kodi i Etikës dhe i Sjelljes dhe me legjislacionin i cili kërkon të sigurohet integriteti, nderi dhe korrektësia etike;
- Prin si shembull për të tjerët në sjelljet e etikës së lartë, integritetit, paanshmërisë, llogaridhënies dhe parimeve të mosdiskriminimit dhe të drejtave të njeriut;
- Siguron që Prokurori i Shtetit të veprojë në pajtim me parimet dhe mekanizmat e llogaridhënies dhe inkurajon për një kulturë të sjelljes me etikë të lartë, pavarësi, paanshmëri, profesionalizëm dhe pajtim me të cilat kërkon të sigurojë integritetin, nderin dhe korrektësinë etike brenda institucioneve;
- Kërkon mundësi për inovacion dhe ka kurajon mënyrën se si kryhen punët.

Njohuri dhe përvojë praktike nga sistemi i drejtësisë penale (duke përfshirë çështjet relevante të të drejtave të njeriut)

Treguesit (Pyetjet):

- Kupton rolin e Prokurorit të Shtetit brenda sistemit të gjithmbarshëm të drejtësisë penale (duke përfshirë përgjegjësitë e përbashkëta të institucioneve penale të drejtësisë dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve)
- Ka njohuri kredibile dhe të respektuar të ligjit dhe të sistemit të drejtësisë penale duke përfshirë edhe çështjet relevante të të drejtave të njeriut;
- Aftësi për të ndikuar pozitivisht, këshillojë dhe udhëzojë prokurorët lidhur me ligjin dhe procedurat.
- Demonstron të arriturat e punës së tij/saj praktike në sistemin e drejtësisë penale.

Unë: _____ (emri, mbiemri) deklaroj me bindje të plotë se këtë vetë-vlerësim e kam plotësuar vetë dhe se përmbajtja në të është e saktë.

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Forma numër 3

KONCEPT DOKUMENTI

Mbiemri:	
Emri:	

I. Vizioni lidhur politikat dhe strategjitë në Prokurorin e Shtetit dhe KPK për shtatë vitet e ardhshme;

1. Si e vlerësoni situatën në Prokurorinë e Shtetit në vitin 2014?
2. Cilat mendoni se janë përparësitë kryesore të Prokurorisë së Shtetit ?
3. Cilat janë mangësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit?
4. Cilat janë rreziqet, sfidat dhe/apo mundësitë e veçanta?

II. Aftësia drejtuese dhe lidhshipi për të udhëhequr sistemin prokurorial ne shtatë vitet e ardhshme;

1. Cili është vizioni juaj për Prokurorin e Shtetit në 2021?
2. Cilat vështirësi apo rreziqet kryesore i prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?
3. Si do t'i tejkalojnë ato?

III. Shkathtësitë dhe aftësitë menaxheriale për shtatë vitet e ardhshme;

1. Për të përmbushur vizionin tuaj për Prokurorin e Shtetit cilat do të jenë tri objektivat e juaja kryesore dhe pse?

IV. Vizioni për të menaxhuar me personelin ne sistemin prokurorial; dhe

Ju lutem renditni hapat praktik që do t'i ndërmerrenit gjatë shtatë viteve të ardhshme për të përmbushur objektivat kryesore?

1. Cilat hapa do t'i ndërmerreni në 12 muajt e parë?
2. Cilat hapa do t'i ndërmerreni në 4 vitet e para?
3. Cilat hapa do t'i ndërmerreni deri në përfundimin e këtyre 7 viteve?

V. Integriteti, njohuri dhe përvoja praktike të sistemit të së drejtës penale (përfshirë çështjet relevante të të drejtave të njeriut).

1. Përvoja e juaj e deri tanishme?
2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë së sistemit prokurorial??
3. Cfarë do të ndërmerrni për të adresuar rekomandimet e KPK-së, lidhur me anketën për prokurorë për vitin 2013???
4. Cfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar se prokurorët respektojnë të drejtat dhe liritë e të pandehurve në procedurë, me theks të veçantë ndaj grupeve të ndjeshme???

Koncept dokumenti nuk duhet të përmbaje me pak së 20 faqe dhe jo me shume se 30 faqe me shkrim "book antiqua", madhësia 12, hapësirë njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij Koncept dokumenti e kam përgatitur vet, dhe jam në dijeni se koncept dokumenti i Kryeprokurorit të emëruar do të publikohet në ueb faqe.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

TABELA E REZULTATEVE PËR ANËTARËT E PANELIT

EMRI I KANDIDATIT: _____

DATA E INTERVISTËS: _____

EMRI I ANËTARIT TË PANELIT REKRUTUES PËR KPK: _____

Treguesit e vlerësimeve	Rezultatet			Komentet
	Min	Mirë	Max	
1. Vetë-vlerësimi	5	12	20	
2. Koncept dokumenti	10	20	30	
3. Intervista	5	12	20	
4. Integriteti	10	20	30	
Rezultatet e përgjithshme:	30	64	100	

I [] Deklaroj që rezultati i mësipërm e pasqyron vlerësimin tim për kandidatin.

Nënshkrimi: _____

Data: _____